ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **250-26-4064-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" EJONA " SH.P.K.**
NUI	**810089913**
Adresa	**Zahaq**
Vendi	**Peja**
Kodi postar	**30000**
Numri Telefonit	**049137987**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ejona Prelvukaj**
Adresa elektronike	**info@ejona.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**12.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës

08.06.2026 Njoftim per Kontrat

02.07.2026 Hapja e ofertave

21.07.2026 Vendimi i AK 1

31.07.2026 Vendimi i AK 2

10.08.2026 Refuzimi i kerkeses per Rishqyrtim

Vendimi i OSHP 08.10.2026

28.10.2026 Vendimi i AK 3

02.11.2026 Kerkese per Rishqyrtim 2

04.11.2026 Refuzimi i kerkeses per Rishqyrtim 2

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne kemi dorezuar Kerkesen per Rishqyrtim ne afat kohor sipas LPP.

E njejta nuk u trajtua ne teresi nga AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

EJONA SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues "Këshilli Prokurorial i Kosovës", gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ***"Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës"****, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, si dhe me Rregulloren për Prokurimin Publik, përkatësisht:*

1. Neni 7 i LPP-së - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

Autoriteti Kontraktues ka për obligim t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit.

Konsiderojmë se ky parim është cenuar përmes mënyrës së zhvillimit të vlerësimeve dhe rivlerësimeve të njëpasnjëshme, ku ndaj të njëjtës ofertë të EJONA SH.P.K. janë përdorur në faza të ndryshme baza të ndryshme të eliminimit.

2. Neni 27 i LPP-së - Dosja e Tenderit

Vlerësimi i ofertave duhet të bëhet në përputhje me kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në rastin konkret, AK ka interpretuar dallimin e pretenduar në paramasën e EJONA SH.P.K. si "ndërhyrje në dokumentet zyrtare", pa argumentuar efektin material që ky dallim pretendohet se ka pasur në ofertën teknike apo financiare.

3. Neni 52 paragrafi 7 i LPP-së - Kontrolli efektiv i informatave dhe dokumentacionit

Në rast të dyshimit lidhur me informacionin apo dokumentacionin e paraqitur nga një operator ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet të kryejë kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit përkatës.

Kjo dispozitë është veçanërisht relevante lidhur me dokumentacionin e inxhinierit Fatjon Beqa, për të cilin Eksperti Shqyrtues në lëndën OSHP nr. 2026/0619 ka konstatuar se ekzistonin rrethana që kërkonin verifikim të mëtejshëm.

4. Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Autoriteti Kontraktues është i obliguar që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta zhvillojë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit dhe mbi bazën e gjendjes faktike të dokumentacionit të ofertës.

Konsiderojmë se eliminimi i EJONA SH.P.K. gjatë rivlerësimit të tretë nuk është rezultat i një vlerësimi objektiv dhe konsistent të së njëjtës ofertë, duke pasur parasysh se oferta fillimisht është vlerësuar e përgjegjshme, më pas është eliminuar për një arsye tjetër e cila është rrëzuar nga OSHP, ndërsa tani eliminohet mbi një bazë të tretë.

5. Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënien e kontratës

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, kontrata duhet t'i jepet operatorit ekonomik të përgjegjshëm në përputhje me kriterin e dhënies të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Konsiderojmë se pas eliminimit të UP LIFT dhe pas konstatimit nga OSHP se arsyeja e mëparshme e eliminimit të EJONA SH.P.K. ishte e pabazuar, AK është dashur të zhvillojë një rivlerësim objektiv dhe në përputhje të plotë me vendimin e OSHP-së.

6. Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë / sqarimi i dokumentacionit

Në rastet kur informacioni apo dokumentacioni i paraqitur kërkon sqarim ose verifikim, AK duhet të veprojë në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Kjo dispozitë është relevante veçanërisht lidhur me detyrimin e AK-së për verifikimin e dokumentacionit të kontestuar të inxhinierit Fatjon Beqa, sipas konstatimeve të ekspertit dhe Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0619.

7. Neni 105 i LPP-së - Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit

Vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për palët dhe Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimit duhet të veprojë në përputhje me urdhrat, konstatimet dhe obligimet që rrjedhin nga vendimi përkatës.

Në rastin konkret, AK nuk ka paraqitur dëshmi se ka zbatuar në tërësi konstatimet e OSHP-së lidhur me verifikimin e dokumentacionit të inxhinierit Fatjon Beqa.

8. Neni 17.2 dhe Neni 17.7 i Rregullores për Prokurimin Publik, të cilave u është referuar AK

AK e ka mbështetur eliminimin e EJONA SH.P.K. në nenet 17.2 dhe 17.7, duke pretenduar se EJONA ka “ndërhyrë në dokumentet zyrtare të AK-së”.

Konsiderojmë se këto dispozita janë zbatuar dhe interpretuar gabimisht në rastin konkret, sepse AK nuk ka argumentuar se dallimi i konstatuar ka ndryshuar çmimet, sasitë, vlerën e ofertës apo ndonjë element tjetër material të ofertës së EJONA SH.P.K.

Për më tepër, një interpretim i tillë duhet të bëhet në përputhje edhe me praktikën vendimmarrëse të OSHP-së lidhur me ndryshimet/ndërhyrjet në paramasë dhe ndikimin material të tyre në përgjegjshmërinë e tenderit.

9. Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0619 dhe Raporti i Ekspertit Shqyrtues

AK ka qenë i obliguar që gjatë rivlerësimit të veprojë në përputhje me konstatimet e OSHP-së dhe të ekspertit shqyrtues.

Në veçanti, eksperti ka konstatuar se eliminimi i UP LIFT për një arsye tjetër **nuk e zgjidh çështjen e saktësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit të paraqitur për inxhinierin Fatjon Beqa**, dhe ka kërkuar që gjatë rivlerësimit AK ta shqyrtojë dhe verifikojë këtë dokumentacion.

Moszbatimi i këtij obligimi përbën mosrespektim të vendimit të OSHP-së dhe të obligimeve të përcaktuara për procesin e rivlerësimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1
- Eliminimi i pabazuar i EJONA SH.P.K. – nuk ka pasur ndërhyrje në paramasë

EJONA SH.P.K. kundërshton në tërësi konstatimin e AK-së se kemi "ndërhyrë në dokumentet zyrtare të AK-së".
Deklarojme se ne OE EJONA SH.P.K. nuk ka ndryshuar dhe nuk ka ndërhyrë në përmbajtjen e paramasës.
Pjesa e tekstit të cilës i referohet AK nuk është paraqitur e plotë gjatë printimit/skanimit të dokumentit. Pra, kemi të bëjmë me mënyrën e paraqitjes së dokumentit gjatë printimit dhe jo me ndryshim të qëllimshëm të përmbajtjes së paramasës.
Për më tepër, teksti që nuk është paraqitur në printim nuk përbën produkt, material apo pajisje që EJONA është dashur ta furnizojë, por është vetëm pjesë e përshkrimit teknik të ashensorit ekzistues në PTH – Gjakovë, i cili është objekt i mirëmbajtjes dhe servisimit.
Me dorëzimin e ofertës dhe çmimit përkatës, EJONA SH.P.K. ka pranuar kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe ka ofertuar për mirëmbajtjen dhe servisimin e ashensorit të përshkruar nga AK.
Pjesa e tekstit që nuk është shfaqur gjatë printimit nuk ndryshon çmimin, sasinë, shërbimin e ofertuar, objektin e mirëmbajtjes apo ndonjë element tjetër material të ofertës.

Prandaj, konstatimi se EJONA ka "ndërhyrë në dokumentet zyrtare" është i pabazuar dhe i jep një problemi teknik të paraqitjes së dokumentit një kuptim juridik që ai realisht nuk e ka.
Kjo mbështetet edhe nga praktika e vetë OSHP-së. Në Vendimin nr. **2024/0372**, është trajtuar një rast ku operatori ekonomik kishte bërë ndryshim faktik në formën e paramasës

duke shtuar rubrikë/kolonë që nuk ishte pjesë e formularit origjinal.
Megjithatë, është konstatuar se përderisa ky ndryshim nuk ndikonte në çmimin, poentimin apo elementet materiale të ofertës, ai nuk duhej të shërbente si bazë për eliminim.
Në rastin tonë situata është edhe më e qartë: EJONA nuk ka shtuar apo ndryshuar paramasën, por gjatë printimit nuk është paraqitur një pjesë e tekstit të ashensorit ekzistues, pa asnjë ndikim në ofertën tonë.
Gjithashtu, kjo është e njëjta paramasë që AK e ka pasur që nga fillimi i procedurës.
Në vendimin e parë, EJONA është shpallur OE i përgjegjshëm.
Në vendimin e dytë, AK na ka eliminuar për një arsye tjetër, e cila më pas është rrëzuar nga OSHP në lëndën nr. 2026/0619.
Vetëm tani, në vendimin e tretë, AK e përdor këtë çështje të printimit si arsye të re për eliminimin tonë.
Kjo kronologji, së bashku me faktin se dallimi i konstatuar nuk ka asnjë ndikim material në ofertë, tregon se eliminimi i EJONA SH.P.K. është i pabazuar.

Për këto arsye, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ta aprovojë këtë pretendim ankimor si të bazuar, ta anulojë eliminimin e EJONA SH.P.K., të konstatojë se dallimi i pretenduar nuk përbën bazë për shpalljen e ofertës sonë si të papërgjegjshme dhe ta urdhërojë AK-në të vazhdojë procedurën në përputhje me LPP-në dhe vendimet e OSHP-së.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2

Moszbatimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0619 lidhur me verifikimin e dokumentacionit të inxhinierit Fatjon Beqa

EJONA SH.P.K. konsideron se AK gjatë rivlerësimit nuk e ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0619, konkretisht sa i përket verifikimit të dokumentacionit të inxhinierit Fatjon Beqa, të paraqitur nga OE UP LIFT L.L.C.
Në procedurën paraprake, EJONA SH.P.K. kishte ngritur çështjen se UP LIFT e kishte paraqitur z. Fatjon Beqa si pjesë të stafit për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa parakontrata e dorëzuar i referohej një aktiviteti tjetër të prokurimit. Për më tepër, vetë z. Fatjon Beqa kishte deklaruar se për aktivitetin konkret nuk kishte marrëveshje paraprake me UP LIFT.
Eksperti Shqyrtues e ka konsideruar këtë mospërputhje si çështje që kërkonte verifikim dhe ka konstatuar qartë se eliminimi i UP LIFT për një arsye tjetër nuk e zgjidh çështjen e saktësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit të paraqitur në ofertë.
Për këtë arsye, gjatë rivlerësimit AK është dashur të verifikojë dokumentacionin e z. Fatjon Beqa dhe, sipas nevojës, të kërkojë sqarimet përkatëse.
Mirëpo, në vendimin e ri AK vepron përsëri në të njëjtën mënyrë: UP LIFT eliminohet për çmime 0.00 në disa pozicione, mosvazhdim të sigurimit të tenderit dhe mosvazhdim të validitetit të ofertës, ndërsa në vendim nuk paraqitet asnjë rezultat i verifikimit të kërkuar lidhur me z. Fatjon Beqa.
Pra, AK ka bërë pikërisht atë që Eksperti Shqyrtues kishte konstatuar se nuk është e

mjaftueshme – e ka eliminuar UP LIFT për arsye tjera, pa e zgjidhur çështjen për të cilën OSHP e kishte kthyer aktivitetin në rivlerësim.
Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme sepse, nëse z. Fatjon Beqa nuk kishte marrëveshje me UP LIFT për aktivitetin konkret, atëherë duhet të verifikohet edhe saktësia dhe vlefshmëria e dokumentacionit dhe informatave të paraqitura në ofertë, si dhe pasojat përkatëse që mund të rrjedhin lidhur me Deklaratën nën Betim.
EJONA SH.P.K. nuk kërkon që kjo të paragjykohet, por kërkon që AK të kryejë pikërisht verifikimin që është kërkuar në procedurën para OSHP-së dhe të paraqesë rezultatin e tij.

Për më tepër, edhe në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka përsëritur të njëjtin arsyetim, duke u mbështetur në eliminimin e OE UP LIFT L.L.C. për arsye të tjera, pa paraqitur rezultat konkret të verifikimit të dokumentacionit të z. Fatjon Beqa. Kjo tregon se AK, edhe pas ngritjes së kësaj çështjeje në Kërkesën për Rishqyrtim, nuk ka dhënë përgjigje përmbajtësore lidhur me pretendimin tonë dhe konstatimet e Ekspertit Shqyrtues.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se rivlerësimi nuk është realizuar në përputhje të plotë me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0619. Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ta aprovojë këtë pretendim ankimor si të bazuar, ta anulojë vendimin e AK-së të datës 28.10.2026 dhe ta urdhërojë AK-në të veprojë në përputhje të plotë me Vendimin e OSHP-së dhe konstatimet e Ekspertit Shqyrtues, duke kryer dhe dokumentuar verifikimin e kërkuar lidhur me z. Fatjon Beqa.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3
Anulimi i aktivitetit të prokurimit është i pabazuar

AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka mbetur asnjë operator ekonomik i përgjegjshëm.
Mirëpo, ky përfundim është pasojë direkte e eliminimit të pabazuar të EJONA SH.P.K. Siç është argumentuar në Pretendimin nr. 1, EJONA SH.P.K. nuk ka ndërhyrë në paramasë dhe pjesa e tekstit që nuk është paraqitur gjatë printimit nuk ndryshon çmimin, sasinë, shërbimin e ofertuar apo ndonjë element material të ofertës.
Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për përshkrimin e ashensorit ekzistues që do të mirëmbahet dhe jo për produkt apo pajisje që është dashur të furnizohet.
Rrjedhimisht, nëse eliminimi i EJONA SH.P.K. është i pabazuar, nuk ekziston as baza faktike dhe juridike për anulimin e aktivitetit me arsyetimin se nuk ka ofertë të përgjegjshme.

Duke qenë se UP LIFT është eliminuar nga vetë AK, ndërsa oferta e EJONA SH.P.K. duhet të konsiderohet e përgjegjshme, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ta aprovojë këtë pretendim ankimor si të bazuar, ta anulojë vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe ta urdhërojë AK-në të vazhdojë procedurën me dhënien e kontratës në përputhje me rezultatin e ligjshëm të vlerësimit.

PËRFUNDIM DHE KËRKESË

Nga të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, konsiderojmë se Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 28.10.2026 është i pabazuar dhe nuk pasqyron një rivlerësim të drejtë dhe të plotë të aktivitetit të prokurimit.

EJONA SH.P.K. nuk ka ndërhyrë në paramasën e Autoritetit Kontraktues. Mosparaqitja gjatë printimit e një pjese të tekstit, e cila për më tepër paraqet vetëm përshkrimin e ashensorit ekzistues që do të mirëmbahet dhe jo produkt apo pajisje për furnizim, nuk ka ndryshuar çmimin, sasinë, objektin e kontratës apo ndonjë element material të ofertës sonë. Për këtë arsye, një mangësi e tillë teknike në paraqitjen e dokumentit nuk mund të shërbejë si bazë për eliminimin e ofertës.

Njëkohësisht, gjatë rivlerësimit AK nuk ka dëshmuar se ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0619 lidhur me verifikimin e dokumentacionit të inxhinierit Fatjon Beqa, por UP LIFT është eliminuar përsëri për arsye të tjera, ndonëse Eksperti Shqyrtues kishte konstatuar shprehimisht se eliminimi për një arsye tjetër nuk e zgjidh çështjen e saktësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit të kontestuar.

Për më tepër, nuk mund të anashkalohet fakti se e njëjta ofertë e EJONA SH.P.K. fillimisht është vlerësuar e përgjegjshme, më pas është eliminuar për një arsye tjetër e cila është rrëzuar nga OSHP, ndërsa pas kthimit në rivlerësim paraqitet një arsye e re për eliminimin e saj.

Për këto arsye, EJONA SH.P.K. kërkon nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që:

Ta APROVOJË në tërësi si të bazuar ankesën e EJONA SH.P.K.;
Ta ANULOJË vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, si dhe Njoftimin mbi Vendimin e datës 28.10.2026, përmes të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit;
Ta KONSTATOJË si të pabazuar dhe të kundërligjshëm eliminimin e EJONA SH.P.K., duke urdhëruar Autoritetin Kontraktues që ofertën tonë ta trajtojë si të përgjegjshme, pasi dallimi i pretenduar në paramasë nuk përbën ndryshim material të ofertës;
Ta KONSTATOJË moszbatimin e plotë të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0619 dhe ta urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të zbatojë konstatimet e këtij vendimi, përfshirë verifikimin e dokumentacionit të kontestuar të inxhinierit Fatjon Beqa, të paraqitur nga OE UP LIFT L.L.C.;
Ta URDHËROJË Autoritetin Kontraktues që ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, duke korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe duke zbatuar në tërësi vendimet e

OSHP-së, dispozitat e LPP-së dhe aktet përkatëse nënligjore;
Të urdhërojë vazhdimin e procedurës drejt dhënies së kontratës, duke marrë parasysh se UP LIFT është eliminuar nga vetë Autoriteti Kontraktues, ndërsa eliminimi i EJONA SH.P.K. është i pabazuar, me qëllim që kontrata t'i jepet operatorit ekonomik që plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e kontratës.

EJONA SH.P.K. kërkon nga OSHP-ja që gjatë shqyrtimit të kësaj ankese të marrë parasysh edhe historikun e tri vlerësimeve/rivlerësimeve të njëpasnjëshme, ndryshimin e vazhdueshëm të arsyeve të eliminimit dhe moszbatimin e plotë të vendimit paraprak të OSHP-së, me qëllim parandalimin e përsëritjes së shkeljeve dhe sigurimin e një përfundimi të ligjshëm të aktivitetit të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si rezultat i eliminimit të pabazuar të EJONA SH.P.K. dhe anulimit të aktivitetit të prokurimit, kompanisë sonë i shkaktohet dëm i drejtpërdrejtë financiar dhe afarist.
EJONA SH.P.K. ka përgatitur dhe dorëzuar ofertën duke angazhuar staf profesional, kohë dhe resurse financiare, si dhe ka bartur shpenzime shtesë për ndjekjen e procedurave të njëpasnjëshme të rishqyrtimit dhe ankimit.
Dëmi kryesor konsiston në humbjen e mundësisë reale për t'u shpërblyer me kontratë dhe, rrjedhimisht, në humbjen e të hyrave dhe fitimit të pritshëm nga realizimi i saj, veçanërisht duke pasur parasysh se oferta e EJONA SH.P.K. fillimisht është vlerësuar e përgjegjshme, ndërsa arsyeja e mëparshme e eliminimit tonë është konstatuar e pabazuar në procedurën para OSHP-së.
Përveç dëmit financiar, rivlerësimet e përsëritura dhe eliminimi mbi baza të ndryshme kanë shkaktuar shpenzime administrative dhe profesionale shtesë, angazhim të panevojshëm të resurseve të kompanisë dhe vonesë në realizimin e të drejtave që burojnë nga pjesëmarrja në një procedurë të drejtë dhe të ligjshme të prokurimit.
Për këtë arsye, anulimi i aktivitetit si pasojë e eliminimit të pabazuar të EJONA SH.P.K. cenon drejtpërdrejt interesin tonë juridik dhe ekonomik dhe na shkakton dëm të konsiderueshëm financiar dhe afarist.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*